



SBASHK Arsimimi sot

Maj, 2024

Gazeta elektronike

Vazhdon bashkëpunimi i suksesshëm me Qendrën Amerikane të Solidaritetit Seminar për forcimin e rolit udhëheqës të grave në sindikata



Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë ka mirëpritur idenë e SBASHK-ut që të organizohet një seminar për gratë udhëheqëse me qëllim që veprimtaret sindikale nga SBASHK dhe nga sindikatat shqiptare të arsimit të bëjnë një analizë të gjendjes aktuale të përfaqësimit të femrës në këto tri sindikata e për të dhënë ide e për të nxjerr përfundime për aktivitetet në vazhdim me qëllim që femra të jetë udhëheqëse sindikale në të gjitha nivelet e organizimit sindikal. Në hapje të këtij aktiviteti, drejtori i Qendrës Amerikane të Solidaritetit, Steven McCloud, ka përgëzuar SBASHK-un... (faqe 3)

Deputetja Time Kadrijaj u takua me gratë udhëheqëse sindikale

Gratë duhet të kenë vendosmëri dhe guxim në përballje me sfidat



Gratë udhëheqëse të SBASHK-ut dhe Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë në ditën e dytë të seminarit për forcimin e rolit udhëheqës të grave në... (faqe 3)

Aktivitete të SBASHK-ut në disa komuna të Kosovës



Me angazhim të përkushtuar të koordinаторit për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri... (faqe 4)

Kritika Qeverisë për mungesë të dialogut me sindikatat



Nuk është e jona të bëjmë analizë të dialogut të jashtëm të Qeverisë e as të veprimeve të saj në Veri, por këto po i përmendim për të theksuar se Kurti dhe Qeveria ... (faqe 6)

Respekt nga Shkodra për SBASHK-un



Shoqata Atdhetare "Dukagjini" në kuadër të shënimit të 21-vjetorit të themelimit ka mbajtur nja varg aktivitete kulture e arsimore. Kryetari i kësaj Shoqate, Ndue Sanaj... (faqe 5)



Editorial

Dhuratë e SBASHK-ut për një numër të konsideruar të punëtorëve arsimorë



Edhe këtë vit SBASHK-u vazhdon me traditën e mirë të dërgimit të një numri të konsideruar të anëtareve e anëtarëve të sindikatës sonë për pushime në bregdetin shqiptar. Falë angazhimit e përkushtimit të koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, stafit qendor, komisionit dhe të kryetarëve të nivelit komunal e të universiteteve, ky aktivitet kishte rrjedhë të mbarë gjatë viteve të kaluara dhe pushuesit janë kthyer me përshtypje shumë të mira duke falënderuar kryetarin e SBASHK-ut dhe stafin qendor për këtë dhuratë domethënëse e duke lavdëruar edhe pronarin dhe stafin e Kompleksit Hotelier “Bonita” për angazhimet, që pushuesit të ndjehen mirë e të relaksuar. Rrjedhë të mbarë ky aktivitet i qëlluar do të ketë edhe këtë vit ngase përgatitjet kanë nisur

me kohë.

Anëtarët dhe anëtarët e SBASHK-ut nga të gjitha komunat dhe nga Universitetet do të jenë të ndarë në tri grupe dhe që pushimet të realizohen ashtu si duhet do të përkujdeset Komisioni qendor i udhëhequr nga koordinatori për organizim të brendshëm. Ky komision do të ndihmohet nga veprimtarë të angazhuar sindikalë, të cilët do të përkujdesën për organizimin e këtij aktiviteti që nga nisja e deri në përfundimin e pushimeve.

Në SBASHK ndjehen krenar për organizimin e këtij aktiviteti rekreativ si dhuratë domethënëse për një numër të konsideruar të anëtareve e anëtarëve nga e tërë Kosova për angazhimin e tyre nëpër vite e dekada në arsimimin e edukimin e brezave.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Gjatë muajit

Vazhdon bashkëpunimi i suksesshëm me Qendrën Amerikane të Solidaritetit **Seminar për forcimin e rolit udhëheqës të grave në sindikata**



Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë ka mirëpritur idenë e SBASHK-ut që të organizohet një seminar për gratë udhëheqëse me qëllim që veprimtaret sindikale nga SBASHK dhe nga sindikatat shqiptare të arsimit të bëjnë një analizë të gjendjes aktuale të përfaqësimit të femrës në këto tri sindikata e për të dhënë ide e për të nxjerr përfundime për aktivitetet në vazhdim me qëllim që femra të jetë udhëheqëse sindikale në të gjitha nivelet e organizimit sindikal.

Në hapje të këtij aktiviteti, drejtori i Qendrës Amerikane të Solidaritetit, Steven McCloud, ka përgëzuar SBASHK-un për këtë iniciativë të qëlluar për të theksuar se Qendra që drejton ai do të vazhdojë me mbështetjen e sindikatave që ato të vazhdojnë suksesshëm rrugëtimin si zë i fuqishëm i anëtarësisë.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka falënderuar drejtorin McCloud dhe gjithë stafin e Qendrës Amerikane të Solidaritetit për mbështetjen tani, por edhe në momentet plot sfida në të kaluarën. Jasharaj ka kujtuar edhe vitet e kaluara duke përsëritur mirënjohjen e thellë edhe për Sindikatën e Mësuesve të Amerikës, që në vitet e okupimit,

por edhe sot e gjithmonë vazhdon të jetë mike e madhe e SBASHK-ut. Jasharaj ka përgëzuar nënkryetaren, Vjollca Shala, koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe stafin për angazhimet në realizimin e këtij aktiviteti për t'u shprehur pastaj se janë arritur rezultate të rëndësishme në avancimin dhe forcimin e rolit udhëheqës të femrës në SBASHK dhe do të vazhdohet me përkushtimin që të forcohet roli udhëheqës i femrës në sindikatë.



Këtë veprimtari të rëndësishme sindikale e kanë përshëndetur edhe kryetarët e Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë, Isa Reka e Nevez Kaptelli.

Pas kësaj është hapur bashkëbiseda për rëndësinë e udhëheqjes së grave në sindikata, për sfidat dhe mundësitë e grave në sindikata, për nismat dhe shembujt e suksesshëm të femrave sindikaliste dhe për tema të tjera që kanë të bëjnë me forcimin e rolit udhëheqës të grave në sindikatë.



Deputetja Time Kadrijaj u takua me gratë udhëheqëse sindikale **Gratë duhet të kenë vendosmëri dhe guxim në përballje me sfidat**



Gratë udhëheqëse të SBASHK-ut dhe Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë në ditën e dytë të seminarit për forcimin e rolit udhëheqës të grave në sindikatë janë ndjerë të nderuara që mes tyre ishte deputetja e Parlamentit të Kosovës, Time Kadrijaj, e cila ka inkurajuar pjesëmarrëset e këtij aktiviteti që ta vazhdojnë me përkushtimin dhe që të mos dorëzohen para sfidave të shumta të kohës. “Gratë duhet të kenë vendosmëri dhe guxim në përballje me sfidat”, është shprehur deputetja Kadrijaj. Ajo në kuadër

të bashkëbisedës me gratë udhëheqëse në sindikata ka rikujtuar rrugëtimin e saj dhe të grave të tjera duke u ndalur të demonstratat e viteve të 80-ta, të pjesëmarrja në luftën e lavdishme të UÇK-së dhe në jetën politike në vitet e pasluftës. Deputetja Kadrija u ka thënë grave sindikaliste nga Kosova e Shqipëria se duhet të vazhdojnë me angazhimet dhe duhet të kenë guximin dhe vendosmërinë në përballje me sfidat e kohës, që nuk janë të pakta.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, bashkë me kryetarët e FSASH e të SPASH, Isa Reka e Nevruz Kaptelli, kanë falënderuar deputeten Kadrija duke i

shprehur mirënjohje për angazhimet e saj nëpër vite e dekada në shërbim të popullit e të atdheut e duke qenë kështu shembull i shkëlqyer i gruas shqiptare.




Aktivitetet e SBASHK-ut në disa komuna të Kosovës **Përkushtim i mësimdhënësve për arritjen e njohurive të reja**



Me angazhim të përkushtuar të koordinatorit për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, e të stafit qendror dhe në koordinim me kryetarët e Kuvendeve të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të disa komunave të Kosovës, ishin bërë gjithë përgatitjet për organizimin e trajnimeve në disa komuna bazuar në vullnetin e anëtarëve e anëtarëve të SBASHK-ut. Kësaj radhe është dalluar komuna e Ferizajt ngase atje të shtunën e 1 qershorit aktiviteti i trajnimeve është zhvilluar me 4 grupe të mësimdhënësve. Dy grupe kanë nisur me trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerët Kadri Hyseni e Nexhmedin Gruda dhe dy grupet tjera në trajnimin “Roli i aktiviteteve kreative në mësimdhënie dhe zbatimi i tyre në shkollat fillore”, me trajneren Hanife Shora dhe trajnerin Osman Rustemi. Këto aktivitete janë zhvilluar në shkollat “Tefik Çanga” dhe “Pjetër Bogdani”. Pjesëmarrësit e këtyre aktiviteteve i ka vizituar kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit parauniversitar për komunën e Ferizajt, Fejzullah Vranovci, i cili ka përshëndetur pjesëmarrësit dhe ka falënderuar trajnerët për angazhimin dhe përkushtimin. Ai po ashtu ka shprehur respekt meritore për stafin qendror të SBASHK-ut, i cili po bënë gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë edhe në këtë komunë.

Po të shtunë e 1 qershorit në institucionin arsimor “Vatra e diturisë” të fshatit Livoç të Gjilanit ka filluar trajnimi “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”



me trajnerin, Musli Neziri. Në këtë trajnim marrin pjesë mësimdhënës nga komuna e Novobërdës.




Në këtë vikend, koleget e kolegët nga Malisheva kanë vazhduar në ambientet e shkollës “Hamdi Berisha” me trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” me trajnerin Albert Samdaraxha. Ata i ka vizituar kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë, Skënder Gashi, i cili i ka përgëzuar ata për përkushtimin në përfitimin e njohurive të reja dhe ka falënderuar stafin qendror dhe trajnerin për angazhimet që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë.

Trajnimi “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” ka vazhduar edhe në shkollën “Hasan Prishtina” të Mitrovicës me trajnerin Fevzi Selmani. Ata i ka vizituar kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë, Isa Ismajli, i cili ka bashkëbiseduar me pjesëmarrësit duke i përgëzuar për angazhimin e duke shprehur respekt meritore për stafin qendror të SBASHK-ut.



Kritika Qeverisë për mungesë të dialogut me sindikatat

Qeveria në emër të dialogut të jashtëm, po ngulfat dialogun e brendshëm



Nuk është e jona të bëjmë analizë të dialogut të jashtëm të Qeverisë e as të veprimeve të saj në Veri, por këto po i përmendim për të theksuar se Kurti dhe Qeveria e tij në emër të dialogut të jashtëm dhe veprimeve dhe gjendjes në Veri ka


ngulfatur dialogun e brendshëm dhe ka zhvilluar luftë të vazhdueshme të për shuar sindikatat dhe këtë detyrë e ka marrë nga Kurti ministri Murati.

Ky ministër i urren sindikatat dhe bëri çmos që t'i shuaj ato me përpjekjet fillestare bashkë me Kurtin që të krijojnë tronditje brenda sindikatave dhe të sjellin udhëheqës sindikalë që janë njerëz të tyre. Po ta kishin arritur këtë, atëherë Qeveria do të zhvillonte përditë takime me ta, do të fotografoheshin dhe ata udhëheqës sindikalë të shitur do të ngritnin në qiell Qeverinë duke gënjyer për të. Qeveria Kurti dështoi në këtë përpjekje dhe prandaj SBASHK-u dhe disa nga sindikatat tjera u janë bërë halë në sy dhe nuk pushuan me luftën kundër tyre. Ministri Murati kishte shpresë se me platformën e-Kosova do t'i gjunjëzonte sindikatat duke menduar se anëtarësia do të hezitonte të regjistrohej sepse edhe procedurat janë të koklavitura.

Duhet pranuar se me këtë veprim, të vetmin në Evropën demokratike, ai arriti të godas rënd disa nga sindikatat, sepse anëtarësia e tyre në numër të vogël është regjistruar në këtë platformën e Muratit dhe në mungesë mjetesh ato vështirë se mund të funksionojnë dhe rrezikojnë të shuhen. Murati, syrin e kishte të SBASHK-u për ta shuar, por i shkoi plani huq sepse në këtë platformë u regjistruan me mijëra anëtarë e po vazhdojnë të regjistrohen sepse ata kanë besim të plotë në sindikatën e tyre. Murati duke e parë këtë realitet u inatos dhe bëri tash një veprim tjetër qindra anëtarëve të regjistruar nuk ua ndal kuotën sindikale. Kjo është goditje e radhës e tij, por pa rezultate. Ministri Murati në vend të këtyre goditjeve duhet ta kryej detyrën e tij e të mos e ngulfat dialogun e brendshëm, por të riaktivizojë Këshillin Ekonomik Social dhe përmes tij edhe të krijohen kushtet që të nënshkruhet Marrëveshja Kolektive, e cila vetëm në Kosovë, krahasuar me vendet e Ballkanit e Evropës, mungon. Kryeministri Kurti dhe ministri Murati duhet të pajtohen se këto janë sindikatat në Kosovë dhe këta janë udhëheqës të tyre që janë zgjedhur me votën e anëtarësisë dhe se vetëm kjo votë mund t'i shkarkojë ata dhe të nisë me dialogun e sinqertë me ta duke shqyrtuar kërkesat e anëtarësisë e duke i zgjedhur e realizuar ato.

Respekt nga Shkodra për SBASHK-un

Mirënjohje e veçantë për kryetarin Jasharaj



Shoqata Atdhetare "Dukagjini" në kuadër të shënimit të 21-vjetorit të themelimit ka mbajtur një varg aktivitetesh kulturore e arsimore. Kryetari i kësaj Shoqate, Ndue Sanaj, para pjesëmarrësve të shumët e në një atmosferë festive ka shpalosur fragmente nga aktivitetet e shumta të kësaj Shoqate që nga themelimi duke veçuar botimin e shumë veprave letrare nga anëtarët e Shoqatës, të gazetës mujore të shtypur "Dukagjini", e në të cilën u është dhënë hapësirë meritore edhe ngjarjeve e aktiviteteve kulturore në Kosovë. Në kuadër të shënimit të këtij përvjetori të rëndësishëm, kjo Shoqatë ka zhvilluar edhe aktivitete arsimore, në të cilat kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj dhe Blendor Shatri.

Në ceremoninë festive, Shoqata Atdhetare "Dukagjini" ka ndarë mirënjohjen e veçantë me emrin e mësueses dhe veprimtares së shkollës së parë në Shkodër për femra, Kushë Micja. Në shenjë respekti për SBASHK-un dhe punëtorët arsimorë të Kosovës që kanë bërë angazhime sublimë në ruajtjen e arsimit shqip sidomos në vitet e 90-ta, mes mësimdhënësve dhe nxënësve të përzgjedhur nga shkollat e Shkodrës, Shoqata ka ndarë mirënjohjen e veçantë në emrin e mësueses së parë të femrave në Shkodër edhe për kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj.

Kryetari Jasharaj duke u shprehur i nderuar ka deklaruar se kjo mirënjohje u takon gjithë punëtorëve të arsimit në Kosovë, të cilët kanë bërë sakrifica sublimë në ruajtjen e arsimit shqip në vitet e 90-ta nga sulmet e pushtuesit serb.




Flasin disa nga pjesëmarrëset e seminarit për gratë udhëheqëse në sindikatë **Aktivitetet të tilla duhet organizuar edhe në të ardhmen**



Ideja e SBASHK-ut për një aktivitet të përbashkët të grave udhëheqëse në sindikatë të Kosovës dhe Shqipërisë është përkrahur nga Qendra Amerikane e Solidaritetit. Ky aktivitet ka mundësuar që të takohen e të bashkëbisedojnë gratë udhëheqëse të SBASHK-ut dhe të Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë. Lidhur me këtë aktivitet biseduam me disa prej pjesëmarrësve .

Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, tregoi se ishte ide e qëlluar e SBASHK-ut për një aktivitet të tillë sindikal. Ajo falënderoi Qendrën Amerikane të Solidaritetit, që edhe kësaj radhe mbështeti këtë ide. Nënkryetarja Shala thotë se gjatë seminarit janë prezantuar tema kyçe lidhur me forcimin e rolit udhëheqës të gruas në sindikata duke shtuar se SBASHK-u është shembull i mirë për këtë dhe se janë shënuar arritje të shumta duke përmendur edhe shembujt konkret.



Koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, vlerësoi se ky aktivitet ka arritur objektivat ngase janë prezantuar përvojat e angazhimeve sindikale të kolegeve në Shqipëri e Kosovë. Ai ka falënderuar drejtorin Steven McClaud dhe stafin e Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë për bashkëpunimin korrekt dhe të frytshëm duke kujtuar se bashkërisht kanë zhvilluar shumë aktivitete

sindikale, që kanë rezultuar shumë të suksesshme.



Besarta Krasniqi Asllani ka marrë pjesë aktivisht në bashkëbiseda duke vlerësuar se duhet vazhduar me përkushtimin që gruaja të jetë e pranishme në të gjitha aktivitetet sindikale sepse ajo është dëshmuar edhe në procesin edukativ e arsimor dhe se meriton të jetë edhe në udhëheqje në sindikatë, që naga shoqata sindikale edhe deri edhe në nivelin qendror.

Shpresa Nushi tregon se është nënkryetare e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar në Pejë duke shtuar se ky aktivitet ishte shumë i qëlluar ngase u krijua mundësia për diskutime të hapura dhe po ashtu edhe për takime me kolegët nga Shqipëria për të parë përvojat sindikale, por edhe përvojat në procesin arsimor në Kosovë e në Shqipëri. Kjo ka bërë që të mësojmë nga njëra-tjetra dhe përvojat e mira t'i përdorim e t'i bartim edhe të kolegët e kolegët tanë kudo në Kosovë.

Edhe pjesëmarrësja në këtë aktivitet sindikal Flora Shabanaj ka vlerësuar lartë gjithë rrjedhën e seminarit duke theksuar se bashkërisht me koleget nga Shqipëria kanë debatuar e bashkëbiseduar për gjithë çështjet aktuale në sindikata dhe për sfidat me të cilat përballën sindikalistët e në veçanti gratë sindikaliste e duke u pajtuar se takime të tilla duhet organizuar edhe në të ardhmen për të forcuar bashkëpunimin mes sindikatave të dy shteteve.

